

**BASHKIA MALIQ**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2014 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, gërma a, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës të menyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndyshuar, kreu II, pika 4 dhe pika 5, Udhëzimi nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Vendimit nr.672 datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës të menyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Vendimit nr.6/1, datë 30.11.2022 të Këshillit Mbikqyrës të “Kombinatit të Sheqerit ” Sha Maliq, Vendimit të Keshillit të Bashkisë Nr.117, datë 23.12.2022, si organ që ushtron të drejtën e përfaqesuesit të pronarit të pronës shtetërore

1- Të dhënat e pasurisë që do të jepet me qira:

- a. Emertimi - “Pasuritë shtetërore me nr.1/249, nr.1/233, 1/246 në zonën kadastrale 2573, në Kombinatit e Sheqerit Sh. A Maliq” (sipas skicës bashkëngitur Vendimit të Këshillit Mbikqyrës)
- b. Sipërfaqja e objektit - Sipërfaqe ndërtese 255 m<sup>2</sup> dhe trualli 639 m<sup>2</sup>
- c. Qëllimi i përdorimit - Prodhim, përpunim dhe tregëtim të prodhimeve të detit.
- d. Vlera dysheme e qirase mujore:
  - Për sipërfaqen e objektit sipas VKM nr.54, datë 05.02.2014, i ndyshuar është ( 84 lekë/m<sup>2</sup>).
  - Për sipërfaqe do të jetë sipas VKM nr.54, datë 05.02.2014, i ndyshuar Aneksi C është ( 20 lekë/m<sup>2</sup>).
- e. Afati i dhënies me qira: 20 (njëzetë) vjet
- f. Veprimtaria që do të ushtrohet në objekt: “Prodhim, përpunim dhe tregëtim të prdhimeve të detit”

2- Pikët vlerësuese për elementët e konkurimit sipas pikës 3 dhe 4 kreut të I-rë të jenë :

- |                                       |         |
|---------------------------------------|---------|
| a. Niveli i investimit                | 35 pikë |
| b. Niveli i të punësuarëve            | 35 pikë |
| c. Oferta e detyrimit mujor të qërasë | 20 pikë |
| d. Gjëndja e llogarisë në bankë       | 10 pikë |

3- Dokumentacioni i konkurentëve do të paraqitet:

- a) Vendi - Zyra e protokollit , Kati i I-rë, Bashkia Maliq
- b) Data - 03.07.2024
- c) Ora - 10<sup>oo</sup>

4- Konkurrentët e interesuar për marrjen me qira të objektit: “Pasuritë shtetërore me nr.1/249, nr.1/233, 1/246 në zonën kadastrale 2573, në Kombinatin e Sheqerit Sh. A Maliq” me sipërfaqe ndërtese 255 m<sup>2</sup> dhe trualli 639 m<sup>2</sup>, duhet të plotësojnë këtë dokumentacion:

- a- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrencës, të parashikuar sipas planit të biznesit.
- b- Plan-biznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
  - Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
  - Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
  - Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
  - Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.

Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër;

- c- Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
  - Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues;
  - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
  - Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
  - Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteoze në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksoj se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
  - Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
- d- Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të lëshuar brenda 15 ditëve nga afati i fundit i dorëzimit të ofertave.
- e- Vërtetim nga Prokuroria që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, të lëshuar brenda 15 ditëve nga afati i fundit i dorëzimit të ofertave
- f- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin 2021 sipas ekstraktit të regjistrit tregëtar.